



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr. 11, datë 14.10.2021

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
NËNTOKËSOR PËR UJË TË AMBALAZHUAR, SUBJEKTIT
“INTER KO SAKT” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore nëbrigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhetë afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të ambalazhuar, subjektit “Inter Ko Sakt” sh.p.k., me vendndodhje Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë, sipas këtyre koordinatave:

2. Treguesit janë si më poshtë:

Vendndodhja e pus-shpimit:

- X=484410.6
- Y=4576768
- Z=106 m.m.n.d

Prurja e kërkuar: 1 l/sek

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KBU ISHËM

ROLAND NASTO

